



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

EML.nr.1/2021

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Shukri Sylejmani dhe Beshir Islami, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit – propozuesit Y.sh.p.k. Nish, të cilin e përfaqëson Av. Habib Hashani nga P., kundër të paditurit – kundërshtarit të propozimit P. “ C. G. SH.P.K. “ L., me seli në P., të cilin e përfaqëson Av.Alija Ajro nga P., për shkak të kërkesës së propozuesit për shpalljen e vendimit të arbitrazhit të ekzekutueshëm, duke vendosur sipas kërkesës së Prokurorit të Shtetit për mbrojtjen e ligjshmërisë, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë IV.EK. nr.504/20 dt.27.09.2021 , në seancën e kolegjit të mbajtur me 27.05.2022, mori këtë,

A K T V E N D I M

HEDHET si e palejuar kërkesa e Prokurorit të Shtetit për mbrojtjen e ligjshmërisë, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, IV.EK.nr.504/20 datë 27.09.2021.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, IV.EK.nr.504/20 dt.27.09.2021, shpallet i ekzekutueshëm vendimi i Arbitrazhit të Huaj – Arbitrazhit të Përhershëm, pranë Odës Ekonomike të Serbisë, në Beograd, Vendimi T- 5/2019 dt.2.06.2020, i korrigjuar dhe plotësuar me Vendimin T- 5/19 dt.29.06.2020, me të cilin është vendosur në mënyrë meritore në çështjen juridike kontestimore në mes të paditësit –

propozuesit Y. sh.p.k. Nish, kundër të paditurit – kundërshtarit të propozimit P. “ C. G. SH.P.K.” L., me seli në P., në tërësi si në dispozitivin e vendimit të lartë cekur.

Kundër aktvendimit të sipër përmendur të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Prokurori i Shtetit, ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të, siç thuhet në të, aktvendimi në fjalë është marrë në kundërshtim me nenin V të Konventës për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Arbitrazhit të Huaj, respektivisht në kundërshtim me nenin 39.5, pika b) të Ligjit për Arbitrazhin e Kosovës, me propozim që të miratohet kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, ndërsa, aktvendimi i lartë cekur, të shfuqizohet dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë për shqyrtim dhe vendimmarrje.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së paraqitjes së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit, kundër aktvendimit të sipër përmendur, në pajtim me nenin 245.1 dhe nenin 246 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit, është e palejuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Prokurori i Shtetit ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktvendimit të sipër përmendur të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me të cilin është shpallur i ekzekutueshëm Vendimi i Arbitrazhit të Huaj- Arbitrazhit të Përhershëm në Odën Ekonomike të Serbisë, në Beograd, T-5/2019 dt.2.06.2020 i korrigjuar dhe i plotësuar më dt.29.06.2020, me të cilin është vendosur në mënyrë meritore në çështjen juridike kontestimore midis paditësit – propozuesit Y. sh.p.k. N. dhe të paditurit – kundërshtarit të propozimit P. “ C. G. SH.P.K.” L., me seli në P., si në dispozitivin e vendimit të lartë cekur.

Ndërkohë që, në këtë gjendje të kësaj çështje dhe në kontekstin e mësipërm, duhet pasur parasysh, se me dispozitën e nenit 37.3 të Ligjit për Arbitrazhin të Republikës së Kosovës, parashihet se “ Kundër aktvendimit të Gjykatës në rastet e parapara me nenin 36, par.2, lejohet ankesa. Për të gjitha aktvendimet tjera të nxjerra nga Gjykata në pajtim me këtë ligj nuk lejohet ankesa “ , sikundër është edhe rasti konkret me aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, me të cilin është shpallur i ekzekutueshëm aktvendimi përkatës i arbitrazhit, dhe pasi që e njëjta ka gjetur se shpallja e aktvendimit përkatës të ekzekutueshëm, nuk është në kundërshtim me dispozitat e nenit 39.5 pika a) dhe b) të Ligjit për Arbitrazhin të Kosovës, përkatësisht, nuk ka të bëjë me kontestin që nuk mund të zgjidhet përmes arbitrazhit dhe nuk është në kundërshtim me rendin publik (ordre public) të Republikës së Kosovës. Prandaj, në prani të faktit se kemi të bëjmë

me dispozita të veçanta të një Ligji Special, si dispozitat e nenit 36, nenit 37, nenit 38, nenit 39 të Ligjit për Arbitrazhin të Republikës së Kosovës, (e për dallim nga dispozitat e LPK-së, nenit 245 etj, në vazhdim të tij), këtu, në rastin konkret civil juridik, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit, në kontekstin e dispozitave të sipër cekura, nuk lejohet.

Prandaj, nga arsyeja e sipër përmendur, Gjykata Supreme e Kosovës, kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit, u dashtë që ta hedh si të palejuar.

Në mbështetje të dispozitës së nenit 221, nenit 245.1 dhe nenit 246 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

EML.nr.1/2021 datë 27.05. 2022

Kryetari kolegjit
Mr.Sc.Muhamet Rexha

